

Prof. asoc dr. Bashkim Gjergji*

Mediat lokale kanë nevojë për portret!

Abstrakt

Kur flitet për mediat lokale, mendoj se duhet mbajtur parasysh se çdo pretendim për nivelin dhe performancën e tyre aktuale në këtë treg të tronditur nga zhvillimet teknologjike duhet riparë në sfondin e ecursionit të tyre në rrafsh historik. I përmbahemi këtij koncepti duke u bazuar në idenë se ajo nuk shfaqet papritmas si sfinks, por ka një të shkuar. Pa shkuar thellë në këtë drejtim pasi nuk është vendi për këtë, duam të vëmë në dukje se periudha e viteve '25-'39 në shekullin e kaluar na ofron një panoramë interesante të mediave lokale – kryesisht shtyp i shkruar – që prezantoheshin në tregun e kohës me fizionomitë e tyre ku vulën e linte niveli i zhvillimit të qendrave ku botoheshin, qendra që rrezatonin në rrafshin e kulturës për shkak të përqendrimit të sistemit të edukimit (shkollat e mesme), institucioneve fetare dhe forcave krijuese, shkurt elitat e vendit.

Periudha 1945 – 1990 karakterizohet nga mediat qendrore, që e nisnin "rregullin" nga kryeqyteti, dhe gazetat e radiot lokale, që nga përmbajtja dhe struktura e tyre jo vetëm ishin në hije, por edhe nga një vështrim i shpejtë i përgjithshëm kuptohet se ishin një kopje e reduktuar e medias qendrore dhe me të njëjtat tipare të brendshme: ideologjike, propaganduese, me mangësi të dallueshme qartë informimi dhe me paraqitje skematike të zhvillimeve rajonale. Thënë ndryshe, nuk mund të flitet për një media lokale të mirëfillte me portret profesional të kristalizuar. Kjo panoramë trishtuese e medias lokale, nuk mund të thuhet se ktheu faqe në periudhën e viteve '90të, ajo thjesht gati u zhduk dhe aktualisht ajo çka ofrohet si e tillë është ndonjë stacion radioje dhe kanale televizive me transmetime të zbehta dhe me audienca shumë të kufizuara. Për më tepër, si kopje, ato synojnë influenca që mund t'i përftojnë vetëm në linjën komerciale. Zhvillimin e tyre e shohim si një mundësi dhe prioritet në planin mediatik nisur nga mendimi se qytetet, komunitetet e rajonet e vendit kanë nevojë për zërin e tyre, se përgatitja dhe

*Universiteti Evropian i Tiranës, Email: bgjergji@gmail.com

dalja në tregun e punës të kaq shumë studentëve të gazetarisë e komunikimit mund të lehtësojë fazën e ngritjes e rritjes së saj dhe se ka ardhur koha që vendi të ketë një shtyp lokal që nga ana e strukturës përmbajtësore mund të ofrojë modele të ndryshme pasqyrimi si në kanalet klasike ashtu dhe në ato të reja. Dhe gjejmë rast të rimarrim idenë e aspektit komercial për të theksuar se ky faktor nuk mund të mos merret në konsideratë, por çështja është e raporteve të tij me faktorët informim, njohje, zgjerim të horizontit kulturor Përvojat botërore nuk mungojnë, përkundrazi madje, shtimi e fuqizimi i tyre brenda sfondit të zhvillimeve të sotme janë një pikë orientuese për ta instaluar e stabilizuar atë.

Fjalët kyç: media lokale, shtyp i shkruar, medime komerciale

Mediat lokale kanë nevojë për portret!

Nuk do të ishte e drejtë që një diskutim si ky i sotmi mbi median lokale dhe raportet e saj me zhvillimet më të fundit teknologjike të anashkalonte këndshikimin në rrafsh historik, jo thjesht si një element panoramik, por si një sfond që ka ndikuar në situatën aktuale të saj, ka plazmuar një fizionomi të caktuar që tashmë është bërë më komplekse dhe problematike njëkohësisht. Punimet me karakter studimor, që do të na shërbenin si një çelës shpjegues për temën e mediave lokale në çfardo aspekti, janë ende shumë të pakta, veçoj këtu kontributin e profesor Hamit Boriçit dhe Mark Markut si dhe studimet e fokusuara të kolegëve të historisë a të shkencave sociale, që e kanë shfrytëzuar median për qëllimet e tyre studimore. Mbi bazën e këtyre trajtimeve duhet thënë se pas periudhës së Rilindjes e dhjetëvjeçarit të parë të shekullit të 20-të, shtypi i kohës në gjuhën shqipe dhe me tematikë kryesisht ndërgjegjësuese e kombëtare, i kaluar tashmë pas 1912 në Shqipëri, zhvillohet në qytetet kryesore të vendit me fizionomi urbane dhe me një nivel të caktuar kulturor, që kishte ndikim në shkallë vendi. Mjafton t'i referohemi faktit se vetëm në Shkodër fundi i 1800 e fillimi i shekullit të ri e zë me 15 shtypshkronja. Po këtu pas 1913 numërohen 16 gazeta, revista, buletine e vjetarë, në Korçë e Vlorë 6,

ndërkohë që periodikë të tjerë, por më të pakët në tituj, shohin dritë në Tiranë, Durrës, Elbasan, Gjirokastrë.¹

Pa shkuar larg me referime të natyrës historike, dëshiroj të tërheq vëmendjen se edhe në këtë periudhë të ngarkuar politikisht, me probleme urgjente ekonomike dhe për ruajtjen e integritetit territorial të shtetit të ri, me një popullsi në pjesën e saj dërrmuese analfabete, dalin një numër jo i vogël botimesh në raport me kushtet e sipërpërmendura. Në kuptimin që i japim sot termit media lokale, këto vërtetë duken larg tij pasi orientohen nga një përmbajtje e orientuar gjeografikisht, pavarësisht ndikimeve nga mediat e mëdha qendrore e zgjerimit të tematikës përtej këtij ledhi. Qëmtimet e kujdesshme nga një numër studiuesish si dhe faktet e njohura deri më sot evidentojnë se periodikët e periudhës pas pavarësisë së vendit dhe të botuara kryesisht në Shkodër e kanë nuancën e tyre lokale. Në pamje të parë ato sjellin para nesh një shtyp të profilizuar tematik. Sikurse ve në dukje studiuesi Boriçi, këtu shohin dritë “Kalendaritregtar”, —“Guaja shqiptare”, apo revista pedagogjike —“Agni” si dhe shtypi fetar me —“Zërin e Naltë” e —“Hijin e Dritës”.² Fokusimi i tyre në sferat e mësipërme tregon qartë se linjat e tyre editoriale, përmbajtjet e trajtuara u referoheshin komuniteteve fetare, shoqërive tregtare, masës së mësuesve apo grave të qytetit, të cilët përbënin pjesën aktive ekonomike e kulturore të qytetit, kishin interesat dhe këndshikimet e tyre për problemet që u interesonin në rrethanat e veçanta të qytetit ku jetonin e vepronin. Ndaj ky shtyp i profilizuar tematikisht mund të konsiderohet edhe një shtyp i mirëfilltë lokal. Parë me këtë sy nuk do të hezitonim të vinim në dukje se edhe shtypi që ka qarkulluar në Korçë, Pogradec e Gjirokastrë, sa kohë që pranë këtyre qendrave zhvilloheshin ngjarje të vrullshme që lidheshin me përcaktimin e vijës kufitare dhe me përballimin e situatave ekonomike e ushtarake, të cilat ndikonin jo pak në jetën e banorëve, me pasqyrimin e asaj çka ndodhte brenda qendrave urbane e jashtë

¹ Shih H. Boriçi, “Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare (1848-1997)”, enti botues poligrafik “Gjergj Fishta”, Tiranë 1997, f.38-40

² Po aty, f.41

tyre merrte ngjyra lokale, sido që në një sfond të përgjithshëm kombëtar.

Duke e përshkruar këtë fazë të jetës së shtypit lokal, kemi parasysh një përpjekje, që merr jetë dhe tenton të krijojë një fizionomi të vetën, të ketë audiencën e vet lexuese. Pra, është një prirje e re brenda sfondit mediatik shqiptar e nxitur nga faktorë të tillë si ekzistenca e forcave krijuese, iniciativat e individëve me shkollim në Perëndim a gjetkë, nevojat e qyteteve që në varësi të nivelit të zhvillimit dhe problematike sociale t'u jepnin zë banorëve dhe vend trajtimit të tyre, modelet që arrinin të depërtonin nga jashtë kufirit dhe shtimit të numrit të nxënësve, kur arsimi shqip nuk mund të pengohej më!

Periudha e mbretërisë, pavarësisht censurës dhe pengesave të ndryshme në rrugën e ngjitjes, karakterizohet nga lulëzimi i një medieje të shtypur që luajti rolin e saj në trajtimin e çështjeve të mprehta të vendit, që në një farë mënyrë u hapi vend ideve e mendimeve opozitare dhe kontribuoi me sa mundi në emancipimin shoqëror. Nga fundi i viteve '20-të numri i gazetave e i revistave arriti në 72, por shumë pak prej tyre mundën t'i shpëtonin atmosferës brenda medias së kohës dhe modelit të një gazetarie të angazhuar sipas krahëve politikë. Këto pak nuk kanë tipare lokale, por publikohen si të veçanta pasi u përmbahen profileve të tilla tematike si fetare, kulturë, sport, modë dhe kronikë rozë, etj. Krahas tyre shfaqen edhe botimet e Liceut të Korçës, Normales së Elbasanit, Shkollës Teknike, etj.³ Profesor Boriçi është i mendimit se në këto vite zhvillimi i shtypit lokal nuk mbështetej dhe si shembullin më domethënës në këtë drejtim sjell qytetin e Shkodrës me tradita në lëmin e botimeve, që në vitet '30-të nuk kishte një gazetë të opinionit të vet publik.⁴

Media lokale nuk mundi të mëkëmbet e të luajë rolin e saj në periudhën e sundimit komunist. Është e saktë të thuhet se qytetet

³ Shih: Fjalori Enciklopedik Shqiptar. Bot i Akademisë së Shkencave 2008, f. 755-756

⁴ H.Boriçi, vep e cituar, f.99-100

kryesore të vendit patën gazetat e tyre dhe në një sërë syresh edhe radio, madje edhe hapësirë mediatike për minoritetin grek në jug të vendit. Por po kaq e saktë është të thuhet se të gjitha këto sipas modelit të mediave qendrore në Tiranë, madje si pjesë e tyre, ishin megafonë propagandistikë të vijës partiake. Nën presionin e censurës ideologjike fizionomia e tyre përcaktohej nga zhvillimet në Tiranë, aktivitetet partiake në qendër e periferi dhe kronika a ndonjë emision të zbehtë lokal, pa mundur të krahasoheshin e jo më të kapërcenin nga ana e zhanreve, stileve e formave prezantuese median qendrore. Për pasojë, audiencat e qyteteve mbetën kryesisht konsumatorë të produktit mediatik kryeqytetas.

Me këtë paraqitje të përgjithshme e ndoshta pak skematike duam të vemë në dukje se:

- Për shkak të dobësisë së shtetit të ri shqiptar në vitet 1913-1925,
- Mungesës së traditës demokratike,
- Kushteve të vështira ekonomike, që kanë shoqëruar rritjen dhe stabilitetin e tij (shtetit),

Sundimit komunist diktatorial, që nuk la shteg për frymëmarrje dhe zhvillim kreativ edhe në këtë fushë, konkludojmë që në vend, në një shtrirje të konsiderueshme historike, media lokale (kryesisht shtypi, por dhe tjerat më vonë) nuk arriti dot të krijonte —personalitetin e vet profesional”. Kështu ngjarjet e vrullshme politike e shoqërore të viteve 1991-1992 e gjejnë Shqipërinë me një audiencë të etur për një shtyp tjetër, shtyp të ri, nga njëra anë, dhe me një përqendrim të disa pak titujve të rinj, opozitarë që shohin dritë po në Tiranë, nga ana tjetër. Shtypi i shkruar nuk mundi të zhvillohej në zona të ndryshme të vendit e të merrte përsipër atë rol që nuk e kishte pasur të paktën për gati 50 vjet. Në dëm të shtypit lokal vepron:

- Dalja e titujve partiakë dhe jo partiakë në kryeqytet;
- Interesi i shtuar i lexuesve ndaj medias së metropolit shqiptar, më afër politikës dhe ngjarjeve madhore të ditës;
- Mungesa e mjeteve financiare;
- Tendenca e gjeneratave të reja të gazetarëve për të zënë vend në redaksitë e reja pritëse po në kryeqytet;

- Mungesa e institucioneve që do të mbështetnin dhe nxisnin këtë lloj produkti mediatic; dhe së fundi
- Apatia në rritje e konsumatorëve mediaticë, të cilët në kushtet e krizës ekonomike dhe papunësisë që shtohet vazhdimisht jo vetëm që nuk e ndjekin atë, por si remineshencë të së kaluarës diktatoriale me një media ideologjike, e konsiderojnë si një përmbajtje mediale jo reale, larg jetës dhe shqetësimeve të tyre si dhe të frymëzuar nga krahë politikë për interesat e tyre.

Pas viteve '90 – 2000 harta e diversitetit mediatic nga aspekti i llojeve regjistron shtyp të shkruar në Elbasan (që vazhdoi për disa vite me përpjekjet individuale të kryeredaktorit Jolldashi), në Gjirokastër si dhe një botim në greqisht për zonën e minoritetit, shtypi lokal bëhet kështu në një zë pa emër, pa vend në hierarkinë mediatike, ai është thjesht histori.

Por kjo hartë e mediave lokale plotësohet nga bumi i mbi 50 e ca kanaleve televizive private dhe transmetimet e rreth 36 radiove lokale në vitet 2000⁵, të cilat nuk lenë hapësirë për shtypin e shkruar lokal. Dukuritë e reja si pasojë e teknologjive të reja, dhe këtu e kemi fjalën për përdorimin e tyre praktik nga ana e mediave transmetuese lokale apo blogjet, sajtet e ndryshme që i venë në vështirësi ato, janë prirje e kohës. Por këtu nuk kemi ndërmend të merremi me këtë fenomen, as me aspekte të menaxhim e marketingut, me audiencat e sidomos me përmbajtjen e çështjeve etike që vijnë e shpërfaqen si probleme serioze me pasoja në informimin publik. Por bazuar në atë çka shohim çdo ditë shtrojmë pyetjen a kemi vërtetë një media lokale? Duke ndjekur për një kohë bukur të gjatë kanale lokale si Vlorë, Elbasan etj. dhe i fokusuar në mënyrë të veçantë në dy skaje, në Gjirokastër dhe Shkodër, na jep mundësinë për të dhënë fakte sinjifikative për gjendjen reale, dhe ndërkohë jemi të sigurtë se banka e të dhënave dhe komenteve përkatëse plotësohet nga vëzhgimet e

⁵ A. Muka, "70 radio shqip ne 70 vite", bot ABC media center, 2008, f 7-10

kolegëve, çka na ndihmon t'i shpëtojmë kurthit të rreshtimit të shembujve të ngjashëm. Konkretisht:

Në Gjirokastër funksionon Alpo TV, që brenda formatit të tij përfshin një programacion kryesisht me ngjarje që lidhen me jetën në qytet. Edicionet e lajmeve qendrore dhe rubrikat e shkurtra informative janë në oraret 07:30, 12:00, 15:00, 18:00, 20:00 – duke rrezikuar jo pak në aspektin e audiencave, që si në baret e kafenetë e qytetit e po ashtu edhe në banesa nuk anashkalojnë kanalet me frekuencë kombëtare, të cilat transmetojnë në po këto orare. Ndërkaq programet e mëngjesit paralelizojnë televizionet kombëtare: këtu përfshihen leximi i shtypit të ditës, telefonata me teleshikuesit lidhur me tematika të ndryshme, si dhe rubrika informative të ndërthururakëto me hapësira publicitare dhe videoklipe muzikore. Programacionit i shtohen edhe filmat shqiptare dhe të huaj me titra në shqip, me frekuencë dy të tilla çdo ditë.

Televizioni Gjirokastra është simotër e TVSH në rrjetin e transmetimeve lokale. Dhe si i tillë transmeton edhe programacione të TVSH-së.

Channel 7 është kanali tjetër që përpiqet gjithashtu të japë kronika, por roli i tij është mjaft i kufizuar, i zbehtë. Vështirësitë financiare e kanë çuar tashmë drejt një falimenti paraprak duke i pakësuar hapësirën transmetuese dhe numrin e programeve. Ka një staf shumë të vogël dhe mbulon vetëm rubrikat informative të edicioneve të lajmeve dhe hapësira tjetër plotësohet nga filma shqiptarë e të huaj. Sinjali i dobët transmetues ka si pasojë mungesën e kualitetit në zë dhe figurë.

Libohova Online është një media online, e cila përditësohet me lajme dhe ngjarje që lidhen me jetën në qytet. Sipas modelit të njohur tashmë, ajo ofron rubrikat që kanë të bëjnë me opinionet, kuriozitetet dhe informacione rreth sportit, shëndetit e modës. Ndërsa rubrika "Dosier" përmban informacione, shkrime analitike, apo investigime autentike të stafit të website-it.

Kjo tablo e vakët mediatike, me një përmbajtje të sipërfaqshme dhe me një sërë mangësisht për të cilat vështirë se mund të konsiderohet zëri i qytetarëve, një skenë realiste e shqetësimeve dhe e

shkëmbimit të gjerë komunikues në funksion të zhvillimit dhe demokracisë në qytet, nuk është larg asaj që vihet re edhe në ndonjë qytet tjetër. Konkretisht, Shkodra ka një gjallëri më të madhe nga aspekti i numrit të medimeve, por kjo nuk ekskludon problemet që flasin për fizionominë e tyre të mangët profesionale.

Në qytetin e Shkodrës operojnë pesë televizione lokale që janë: Tv1 Channel me pronar një deputet të LSI, Tv Rozafa me pronarë një ish deputet i djathtë, Star-Plus me pronar një biznesmen ndërtimi, Tv Antena me pronarë një *businesswoman* dhe Bly Sky me pronar një biznesmen në fushën e prodhimit të vidioklipeve.

Të gjitha këto televizione përveç Tv Bly Sky, janë me natyrë gjeneraliste që në pjesën më të madhe të përmbajtës janë imituese të mediave kombëtare. Nga bisedat me njerëz të medias konstatohet një shqetësim serioz lidhur me nivelin e punës së redaksive dhe pamundësinë për të bërë hapa para në aspektin profesional. Stafet e reduktuara, pagat modeste dhe interesat e ngushta partiako-ekonomike të pronarëve kanë bërë që këto media të jenë shumë sipërfaqësore, shumë pak lokale (pa asnjë investim dhe pa çështje hiperlokale). Janë media që fokusohen në ngjarje të ditës në aktivitete shoqatash dhe partish, pa u thelluar dhe pa prekur apo krijuar debate me interes për komunitetin.

Vlen të thuhet se gazetarët që po vijnë nga shkollat e gazetarisë janë në nivel të mire, këta punojnë në mediat lokale në kushtet e mësipërme, por punojnë edhe në shumë media kombëtare me intensitet e cilësi më kualitative.

Prej kohësh në aulat e hapura të kanaleve televizive është folur për trinomin media-politikë-biznes, për keq menaxhime dhe nivele të diskutueshme profesionale. Në këtë frymë, pronarët e mediave kanë siluruar motivimin në punë duke aplikuar një nivel të ulët page, diku te 20 mijë lekë, në të gjithë transmetuesit, çka ka dhënë shkas për komentet se për këtë standard pagash ka një marrëveshje mes pronarëve, disa prej të cilëve e shohin mediumin e tyre si mjet për shërbim ose edhe shantazh ndaj individëve e grupeve vendimmarrëse në qytet. Përrjashtim bën Tv Bly Sky, i cili transmeton vetëm muzikë dhe prodhon vidioklipe muzikore, një mënyrë kjo që i ka siguruar

statusin e të vetmit televizion lokal me fitim të drejtpërdrejt nga produkti medatik.

Si një ndër qytetet më të mëdha e me traditë këtu dëgjohen Radio Shkodra (e lidhur me TVSH), Radio Maria me drejtim fetar, Radio Jehona me drejtim fetar dhe informativ dhe Vintage Radio me drejtim muzikor e informativ. Të gjitha televizionet janë dhe në rrjete sociale, ndërsa tre media lokale vetëm me natyrë informative janë në web apo më saktë në rrjetin social facebook. Këto janë media të krijuara nga vetë gazetarët lokalë që drejtohen nga 1 deri në 2 persona. Kjo mbase vjen dhe si nevojë që kanë gazetarët për të dhënë informacionin në një media të tyre, ku nuk ndjehen nën presionin e pronarëve. Po shkojmë drejt një risie ku çdo gazetar po krijon median e tij online si valvul shkarkimi për të shpëtuar nga censura dhe interesat e pronarit. Në Elbasan veçojmë një radio, e pikërisht Albanian Kuran FM, kurse Best Chanel sikurse edhe Skampa kanë më tepër një karakter gjeneralist, modeli ky i përhapur gjerësisht në transmetuesit nga veriu në jug të vendit.

Pas kësaj paraqitje shumë të kufizuar, por me fakte që na afrojnë një imazh të asaj çka ndodh në hapësirat përtej Tiranës. Dhe përsëri pyetja: a kemi vërtetë një media lokale?

Njihen standardet, kushtet, raportet brenda redaksive, sistemet vetërregulluese dhe roli i mediave perëndimore, si ai i qendrave, po ashtu edhe i periferive. Në këtë kuptim, s' duam të bëjmë krahasime që do të tingëllonin jashtë realitetit. Por kjo s' do të thotë se nuk mund t'i referohemi —Community Journalism” të Jock Lauterer, i cili bazuar në përvojën e gjatë të medias lokale amerikane thekson se kush dëshiron të ngrëjë në këmbë një medium të këtij lloji, kush dëshiron të kontribuojë në të duhet të gjejë një histori njerëzore.⁶ Kjo si dhe fakti që njerëzit janë të uritur e kanë nevojë për informacione rreth komunitetit, shqetësimeve të tij si dhe për fqinjët, janë

⁶Të gjitha referimet në lidhje me mediat lokale amerikane janë nga: Jock Lauterer, “Community Journalism”, bot. Iowa State University Press/ Ames, 1995, f. 11, 25, 139, 144, 185- 187, 196, 208, 237.

argumente mbështetëse për ekzistencën e kësaj medie dhe kusht për të përballuar kanalet e mëdha me reputacion botëror si dhe pasojat e fshatit global të McLuhan-it.

Duke e shtruar çështjen në këtë mënyrë, Lauterer përqendrohet te raportimet, stilet (ambalazhet) e tyre në standarde krejt të ndryshme nga ato të mediave të mëdha.

A nuk është me vend që punën e mediave tona lokale ta shohim në këtë dritë? Mendoj se po pasi kjo edhe mediat e mësipërme, por edhe shume të tjera në shkallë vendi do t'i ballafaqonte me aksiomën Shërbim publik/ Interes publik!

Media lokale ka marrëdhënie fundamentale me qytetin, ajo duhet të kujdeset për komunitetin në frymë mbështetëse, pozitive e edukative! Nuk jemi në gjendje që ta pohojmë këtë linjë kur flasim për median jashtë metropolit që, së pari, reflekton mangësitë e shoqërisë në përgjithësi e të medias në tërësi dhe, së dyti, nuk ka fuqinë për të dalë mbi interesat e pronarëve dhe situatat financiare dramatike.

Për më tepër, ndërsa mediat e mëdha me rezatim kombëtar e kanë luksin të shfaqen edhe indiferente në raste të caktuara, të ftohta, kritike e cinike, mediat lokale e kanë për mision të parë rolin ndriçues, sqarues si dhe atë këshillues, inkurajues, mbrojtës për komunitetin ku veprojnë. Pikërisht duke pasur parasysh këto standarde dhe principe etike, mendojmë se mediat tona, të shpërndara në të katër anët e vendit, nuk e përmbushin misionin e tyre, sikurse vihet në dukje më sipër. Emisionet informative të thata, të sipërfaqshme dhe ndonjë kronikë e rrallë apo e simplifikuar nuk na japin të drejtë për të kundërtën. Transmetimet me orë të zgjatura muzikore, me telenovelat pa cilësi, me emisione piraterie dhe pa investime për një të ardhme institucionale më të mirë nuk e zhbëjnë situatën aktuale. Në thelb kemi nevojë për ta zhvilluar, fuqizuar median tonë lokale, e cila duhet të ketë portretin e vet të qartë, emrin e saj të konsoliduar.

Së fundi, duam të vëmë në dukje se këtë sfond nuk janë zhdukur krejtësisht shpresat për një gjallërim dhe mundësi për të bërë diçka. Po përmendim dy: Ekzistojnë projekte, për të cilat s'jemi të autorizuar

të japim këtu hollësi informative (pikërisht se janë ende në fazën kur pritet të realizohen), për instalim transmetuesish me valë të kufizuara dhe portabël (të zhvendosshëm nga njeri vend te tjetri) me një përmbajtje thuajse tërësisht të përqendruar në kushtet e vendit, punët e banorëve, interesat dhe historitë e tyre. Le të shpresojmë. Me rastin e këtij forumi shkëmbimesh idesh e pikëpamjesh, ja vlen të përmendim *Local Media Today*, që flet si për aktivitetet e shoqatave të gazetarëve lokalë (ne s'e kemi ende këtë fat!), për çka ndodh në industrinë mediatike si dhe informacione, reportazhe, ngjarje e tendenca që afektojnë median lokale. Nuk mungojnë aspak burimet e afta njerëzore brenda komunitetit të gazetarëve për ta marrë përsipër një detyrë si kjo, por po ashtu edhe degët e medias dhe komunikimit në degët përkatëse, organizatat mediatike apo institucione si ISHM që mund ta përfshijnë këtë medium në sferën e veprimtarisë së tyre periodike.

Referenca

Hamit Boriçi, —*Në shekull e gjysmë publicistikë shqiptare (1848-1997)*”, enti botues poligrafik —Gjegj Fishta”, Tiranë 1997, f.38-40

Fjalori Enciklopedik Shqiptar. Bot i Akademisë së Shkencave 2008, f. 755-756

Arben Muka, —*70 radio shqip ne 70 vite*“, bot ABC media center, 2008, f 7-10

Jock Lauterer, —*Community Journalism*”, bot. Iowa State University Press/ Ames, 1995